



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-6506/25 datë:24.03.2025



Npi – 01/119 datë: 01.04.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 01.04.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 01.04.2025 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtorët – z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; z.Besnik Ahmeti, DBF: z.Gojart Bajrami, DBPZHR; Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët për Informim znj.Vlora Hyseni, dhe Albion Shabani. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 21.02.2025,
2. Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi – 01/23 datë: 27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë – Nr.05-1376 dt.25.02.2025,
3. Pasqyrat Financiare per vitin 2024,
4. Propozim per ndarjen e te hyrave te bartura nga viti 2024 per vitin 2025,
5. Propozim-Venmdim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit Npi-01/90 datë 12.03.2025 të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme komunale në Zonën Kadastrale – Davidoc,
7. Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/60 datë:13.03.2025 të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes,
8. Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/109 datë:26.03.2025 të Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” të komunës së Shtimes,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 21.02.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 21.02.2025.**

Pika 2

Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi – 01/23 datë:

27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë – Nr.05-1376 dt.25.02.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Kemi një rekomandim nga Ministria e Shëndetësisë për me i larguar disa tarifa nga Rregullorja për Taksa e vitit 2025, dhe me i harmonizuar me U.A të Ministrisë. Dokumentin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar. Meqenëse ky rekomandim është për ta harmonizuar rregulloren me legjilacionin në fuqi unë ju ftoj që ti miratoni këto ndryshime të kërkuara nga Ministria e që kanë të bëjnë me shirjen e Neneve: 10.2.5, 10.2.14, 10.2.15, 10.2.18, si dhe harmonizimin e neneve 10.2.22 dhe 10.2.25 me U.A. Nr.03/2024.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Nuk e kamë të çartë fshirjen e tarifave për sa i përket Certifikatave, a ka mundësi sçarim pak më shumë?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Këto si shërbime shëndetësore që i ofrojmë ne nuk janë të parapara me U.A. për pagesa, kështu që ne këto shërbime duhet ti ofrojmë vullnetarisht.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Fillimisht urime festën e Bajramit. Ne jemi të obliguar që ti përmbahemi Udhëzimit Administrativ. Si profesionist mund të them se ne kemi me ju dale në ndihmë pacientëve si nivel primar shëndetësor. Sa i përket Certifikatave unë mendoj se është e logjikshme, kështu që ne detyrohemi që ta votojmë këtë ndryshim të kërkuar nga Ministria.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e ndryshimeve në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, me numër Npi – 01/23 të datës: 27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë – Nr.05-1376 dt.25.02.2025.**

Pika 3

Pasqyrat Financiare per vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pike, fjalën ja jap drejtorit Besnik Ahmetit për prezantimin e kësaj pike.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Për këtë pikë materialin e keni pranuar me kohë, dhe e keni lexuar. Unë do ti lexoi pikat kryesore nga dokumenti (shih dokumentin). Buxheti i Alokuar në vitin 2024 ka qenë 11,361,029.00 € edhe pse Buxhetin e miratuar në Kuvend e kemi pas 9,906, 819.00 €. Buxheti për vitin 2024 është shpenzuar 97.2%. Borgji i Komunës është 21,000 € ky është borgji më i vogël që ka pas ndonjëher Komuna e Shtimes. Nëse ka dikush ndonjë pyetje konkrete do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit për sçarimin. Qenkan shtuar disa të hyra, te Kontyrata Kolektive qeveria i ka dhënë disa mjete shtesë a është kështu. Sa i përket bartjes na spjego pak për grantin e brendshëm?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Sqaro...

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" me 3 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstënim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e raportit për pasqyrat financiare për vitin 2024.**

Pika 4

Propozim per ndarjen e te hyrave te bartura nga viti 2024 per vitin 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja jap drejtorit Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Edhe për këtë pike materialin e keni marrë me kohë. Shuma totale që duhet të bartet nga vitin 2024 në vitin 2025 është 266,448.06. Ne i kemi propozuar që këto mjete

të ndahen në 13 kategori, e të cilat fillimisht janë plotësuar te projektet e pa kryera. Në vazhdim drejtori sqaroi për secilën kategori vewç e veç, (Shih dokumentin)

z.Përparim Ramusa: Unë kam një pyetje për ty drejtor thae që 180 mijë euro kanë me shku te furnizimi i ndërmarrjes publike komunale, këtu sa po e shoh unë nuk po përputhet me dokumentin që këtu po shkruan menaxhimin e katastrofave. Unë jamë “për” nëse është për pagesën e dëmeve natyrore për qytetarët e dëmtuar.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Lidhur me pytjen e juaj mund të ju them se neve na lejon vetëm ky kod buxhetor për destinimin që e thash. (ky është përshkrimi i programit)

znj.Adelina Beqaj: Qysh mundet me qenë një projekt i ri pa kod buxhetor, po flas për projektin te pika 11 e dokumentit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Po te kjo pike është projekt i ri, sepse nevojat të gjitha i kemi mbuluar te projektet e vjetra.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Sa i përket ndarjes buxhetore është mire që Kuvendarët me i pa edhe kërkesat e drejtorive përkatëse. Unë besoj se është bërë sipas kërkesave të drejtorive dhe për këtë arsye unë mendoj se duhet me u votu. Në disa raste është e domosdoshme me i bërë edhe disa ndryshime brenda kodeve buxhetore.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Pak më thjeshtë secila drejtori e ka buxhetin e vet edhe e ka veç një emër. Psh. Te Shërbimet Publike, financat nuk kanë faj sepse kjo është kuleta e drejtorisë, kështu që Drejtoria e financave nuk ka ku i qet dikund tjetër, qashtu është te lista e financave dhe kodi nuk ndryshon asnjëherë. A ka prioritete të tjera sigurisht që ka, dhe pikërisht për këtë arsye unë nuk pajtohem me këtë ndarje buxhetore.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, (me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim”) vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat në vitin 2024 për vitin 2025.**

Pika 5

Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë

Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtorit Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Nuk do ti përsëriti fjalët që i kamë thenë në mbledhjen e kaluar. Ky është një ndër vendimet më të rendësishme që do ta marrim sepse po bëhet fjalë për objektin para Komune, i cili edhe mënyra se qysh është ndërtuar nën masa të dhunshme serbe të atëhershme, por edhe sipas gjendjes mjeruese që është tani, por ka edhe të meta të shumta teknike e që rrjedhimisht edhe paraqet rrezik për banorët ose kalimtarët e rastit, për arsye se kulmi i objektit qe një kohë të gjatë rrjedh brenda uji i shiut, sepse nuk ka pas kurrë asnjë renovim. Ne pra po bëjmë plan që me e rrënuar këtë objekt, dhe në vendin e tijë me bërë një shesh për qytetarë, dhe nën te një parkim nëntoksor për automjete. Ne si Komunë, por as banorët nuk janë të interesuar për me investuar në këtë objekt. Në këtë objekt ka banesa dhe lokale afariste, e të ciët të gjithë do të kompenzohen, dhe për këtë project janë ndarë nga Qeveria 3 milion euro. Rrënimi i këtijë objekti dhe ndërtimi i një sheshi këtu është në përputhje të plotë edhe me Planin Zhvillimor. Ne kemi pas diskutim me qytetarë respektivisht banorë të objektit, dhe asnjë prej tyre nuk ka qenë kundër. Por ka pas shumë prej tyre që na janë drejtuar me pyetje teknike që më shumë kishin të bënin me çështjen e kompenzimit. Prandaj unë ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit miratimin e vendimit për rrënimin e këtijë objekti.

z.Përparim Ramusa: Ne si PDK-ë do të “abstënojmë” sepse ne kemi biseduar me një pjesë të pronarëve dhe ata nuk e dinë se sa dhe si kanë me ju shpronësuar. Kjo është brengosëse. Arsye politike nuk ka por arsye praktike, mirëpo ne do të diskutojmë në Kuvend më detaisht.

Lumni Amrushi: Unë edhe në mbledhjen e kaluar kamë kërkuar, që a kemi një përgjigje të qartë rreth asajë se në të kaluarën këtu në këtë objekt ka pas të vendosura disa shirita nga krimet ekonomike. Ju drejtor a dini diçka më shumë për këtë çështje? Ka mundësi që nëpër Gjykata të dështojë krejt projekti. Personalisht unë jam “Pro”.

z.Përparim Ramusa: E kam edhe një pyetje drejtor, ky 3 milionëshi që u përmend për këtë projekt a ka lidhje me shpronësimet apo jo?

z.Kadri Emini: Me kërkesën tonë si grup parlamentar i LDK-së kjo pike nga mbledhja e kaluar është shty. Ne kemi dhënë disa rekomandime. Aktualisht ne nuk kemi një Qëndrim deri në mbledhjen e Kuvendit më 03.04.2025, në mbledhjen e Kuvendit ne do të vendosim si grup parlamentar, ndërsa këtu në këtë mbledhje unë jam për "Abstenim", e në Kuvend ta shohim.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Nëse flasim për shpronësimin, askush nuk është i kënaqur qind për qind me vlerësimin e Komisionit të Ministrisë, sepse pritshmëritë janë të larta. Për mua është me prioritet me u paguar për njësitë banesore dhe afariste. Vlera e këtyre lokaleve parimisht është e barazvlefshme me lokalet që janë rreth e përqark. Besoj se nuk mundet me u vlerësu 150 euro metri katror. Të gjithë kanë të drejtë për me i atakuar vlerësimet në Gjykatë. Sa i përket pyetjes për krimet ekonomike, te ne nuk figuron që ka ndonjë ndalesë po flas te fletat poseduese.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, (me 3 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim") vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-banesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, si dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime.**

Pika 6

Shqyrtimi i Rekomandimit Npi-01/90 datë 12.03.2025 të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme komunale në Zonën Kadastrale – Davidoc

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ne si Kuvend e kemi themeluar një Komision për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme komunale Nr.00333-16 në Zonën Kadastrale – Davidoc, me sipërfaqe prej 2894m². Komisioni e ka përfunduar punën e vetë dhe na e ka sjellë një rekomandim Npi – 01/90 datë: 12.03.2025, për ta marrë pastaj edhe vendimin përfundimtar. Dokumentacionin për këtë pikë e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, e hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini: Unë e kam raportin përfundimtar të Komisionit dhe po i lexoj pesë pikat që këta i kanë shkruar, unë konsideroj se këto pika nuk do të realizohen. Ai thot se do të investoj në shumë 190,121.50 euro, praktikisht ai nuk investon kurgjë sepse ai ka investuar moti aty. Pastaj të punësoj 10 punëtor, nuk ta punëson asnjë sepse i ka të punësuar moti këta. Të filloj veprimtarin biznesore brenda 6 muajve, ky e ka filluar qe një vjet. Të filloj veprimtarinë shërbyese e përpunuese, absolut kurgja nuk ka me ba. Paramendoje Komisioni thot është i gatshëm të paguaj qiranë vjetore prej 18 euro për ari. Kështu që unë jam absolut "Kundër". E ju veproni e vendosni si të doni.

znj.Adelina Beqaj: Unë personalisht nuk po flas në emër të PDK-së, tu pas parasysh që ne i kemi dhënë tokë komunale mjaft këtijë njeriu unë personalisht jam "Kundër" këtijë vendimi.

z.Përparim Ramusa: Singerisht po i them Grejtaltit a je ti a ke ndrruar. A e dini ju Vetvendosja qka keni thënë për këtë pronë që e kemi dhënë na atëherë, u qojshin Ruzhdi Jashari edhe Besnik Seferi në mbledhje të Kuvendit e thojshin kriminelin po i jep pronë kriminelit, me rekomandim prej zyrës së juaj. Nuk jamë "Kundër" unë, e di që duhet me kanë parimorë, e jo dje me i thënë kriminel e sot me ja dhënë tokën. Unë për juve e kam qysh keni mundesi tash me kqyr atë njeri në sy, sepse unë edhe atëher edhe tash nuk kamë qenë kundër.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, (me 5 vota "Për" me 2 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim") vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme Komunale Nr.00333-16 në Zonën Kadastrale – Davidoc.**

Pika 7

Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/60 datë:13.03.2025 të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj.Zejnije Veliu.

znj.Zejnije Veliu, Kryesuese e Komisionit për emërtimin e rrugëve: Përshëndetje. Ne si Komision kemi mbajtur gjithësejt 6 mbledhje. Kemi shqyrtuar gjithësejt 19 kërkesa të qytetarëve dhe kemi miratuar rekomandimin e Komisionit për secilën kërkesë. Si Kryesuese e Komisionit mendoj se e kemi bërë një punë mjaft të madhe por edhe një punë të mire, kështu që me nxjerrjen e rekomandimit përfundimtar të cilin tani më ju e keni në duart e juaja ne e kemi përfunduar punën

tone. Dihet që vendimin përfundimtar e merr Kuvendi. Gjatë punës tone ne kemi identifikuar nevojën se:

- Në Komunën e Shtimes ka më shumë se 200 rrugë ose segmente rrugore që kanë nevojë për emërtimin e tyre.
- Komisioni ka identifikuar se ka disa rrugë të cilat janë të emërtuara me vendimin e Kuvendit Npi-01/80 datë 05.04.2013, mirëpo nuk janë të inkuorporuara në Sistemin Elektronik të Adresave. Si dhe ka disa rrugë që janë në Sistemin Elektronik të Adresave por që nuk ekzistojnë fare në Vendimin e Kuvendit, Npi-01/80 datë 05.04.2013, e as në ndonjë vendim tjetër të Kuvendit.
- Prandaj ne kemi Rekomanduar që rrugët që nuk janë në Sistemin Elektronik të Adresave e të cilat janë në Vendim të Kuvendit, duhet të futen në Sistemin Elektronik të Adresave. Te rasti tjetër të gjitha rrugët të cilat janë në Sistemin Elektronik të Adresave dhe nuk janë në vendimet e Kuvendit duhet të shlyhen nga Sistemi Elektronik i Adresave dhe gjendja të kthehet në pikën ku kemi harmonizim të plotë në mes të Vendimit të Kuvendit dhe Sistemit Elektronik të Adresave.

z.Përparim Ramusa: Unë nuk e di se sa ka qenë aktiv Komisioni, kështu që unë nuk jam për me dhanë rekomandim Komisioni as për “Pro” e as për “Kundër”. Propozoj që Kuvendi me votu për secilin Rekomandim veç e veç.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Kemi një problem me fshatrat e pa banuara sikurse është rasti në Topillë. E kam edhe një pyetje shtesë, a përfundon mandate i Komisionit me përfundimin e këtyre Rekomandimeve apo vazhdon më tutje?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Mandati i Komisionit përfundon me nxjerrjen e Rekomandimeve nga ana e Komisionit, ky ka qenë komision për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve ku edhe ka pas një konkluzion të Komisionit për njoftimin e qytetarëve përmes Zyrës për Informim, për mundësinë e parashtrimit të propozimeve për emërtimin e rrugëve në afat prej 10 dite.

z.Kadri Emini: E falënderoj Zejnijen për punën që e ka bërë që e kam pa se ka punuar edhe jashtë orarit të punës. Ka pas edhe tentime që në Komision me i bërë emërtimet vetë. Në fillim ka pas pak kërkesa por ka ardhur duke u rritë numri i tyre, e mira është që nuk kemi pas dy ose më shumë kërkesa për rrugën e njejtë. Unë jam për me shku në bllok me votim për të gjitha Rekomandimet e Komisionit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, (me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim”) vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve sipas Rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve Npi-01/60 të datës 13.03.2025.**

Pika 8

Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/109 datë:26.03.2025 të Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” të komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa: Sa i përket kësaj pike që është propozuar, unë konsideroj se që të dyja figurat e propozuara janë figura meritore, mirëpo ne konsiderojmë se kjo listë duhet të zgjerohet, por do ta diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” për kandidatët: Fadil Hysaj – Shtime dhe Ismajl Hasani – Shtime (Post mortum).**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime të tjera nuk ka, mbledhjen e përfundoi në ora 16:00h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

